




Republika e Kosovës

Republika Kosova

Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj

Opština Skenderaj

Municipality of Skenderaj

Procesverbal i takimit të katërt publik buxhetor për buxhetin e vitit 2027, të mbajtur në Bashkësinë Lokale të Runikut

Data: 21.08.2026

Ora: 15:00

Vendi: SHFMU "Shotë Galica" Runik

Të pranishëm: Nënkrjetari i Komunës z. Fadil Nura, Drejtori i Drejtorisë për Buxhet e Financa z. Behxhet Maliqi, Drejtori i Drejtorisë së Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Ambientit, z. Arbnor Çitaku, Drejtoresha e Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik, Ndërmarrësisë, Inovacionit dhe Turizmit znj. Besarta Meha Ademi, Drejtoresha e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport znj. Kosovare Ahmeti si dhe qytetarët nga lista pjesëmarrëse e bashkangjitur më poshtë.

Nënkrjetari i Komunës z. Fadil Nura: Fjala hyrëse/përshëndetëse – hapja e takimit.

Ky është një takim në kuadër të takimeve ligjore që i kemi rreth planifikimit të buxhetit për vitin e ardhshëm 2027 dhe projeksioneve për 2028-2029. Jemi këtu bashkarisht me iu dëgju, për kërkesat dhe nevojat që i keni si bashkësi lokale edhe pse vazhdimisht kemi qenë në kontakt dhe jemi të njoftuar, por jemi këtu t'iu degjojmë për kërkesat që i keni me me prioritet. Edhe pse buxheti nuk është i mjaftueshëm, përkrahje nga qeveria nuk kemi, jemi të diskriminuar në kuptimin buxhetor.

Por, sidoqoftë jemi këtu bashkë me drejtorët: Drejtori i Financave, Drejtori i Urbanizmit, Drejtoresha e Zhvillimit Ekonomik, Drejtoresha e Kulturës dhe një pjesë të kabinetit, me i'u dëgju, ku çdo kërkesë shënohet, mbahet procesverbal dhe shkon në procedurat për miratimin final të buxhetit të vitit 2027. Fjalën i'a kaloj Drejtorit të Financave, pastaj kalojmë tek ju.

Drejtori i Drejtorisë për Buxhet e Financa z. Behxhet Maliqi: Fjala hyrëse. Para jush i keni fletushkat me buxhetin për vitin 2027 dhe 2028-2029. Bashk me Bordin e Drejtorëve, Kryetarin dhe Nënkrjetarin dhe dëgjimet që i kemi pasë me herët me grupet e interesit, me ojqtë, me bizneset e kemi bërë një buxhet brenda mundësive të përgjegjshëm.

Buxheti për vitin 2027 është 20 milion e 814 e 790 euro në total. Për 1373 punëtor janë nda 12 milion e 252 e 605 euro për paga. 3 milion e 306 mijë e 675 euro mallrat dhe shërbimet. 326 mijë

e 700 euro pagesa për rrymë, për mbeturina për obligime të shërbimeve komunale. 1 milion e 10 mijë euro janë për subvencione. Për projekte kapitale janë planifiku 3 milion e 918 mijë e 810 euro.

Këtë kërkesë e kemi dërguar në qeveri me qarkorën e parë buxhetore, me qarkorën e dytë që e ka dërgu qeveria është bërë një ndryshim që shkon në dëm të projekteve kapitale. Është ulë për 774 mijë e 671 euro në investimet kapitale duke i kaluar në katgorinë e pagave, prej 3 milion e 918 mijë e 810 euro në 3 milion e 144 mijë e 139 euro dhe janë rritë pagat për këtë shumë, kategoria e pagave është 13 milion e 27 mijë e 275 euro në kurriz të buxhetit të Komunës.

Kjo është një rezyme sa i përket strukturës së buxhetit për vitin 2027, nëse keni dikush diçka jam gati për sqarim.

Migjen Spahiu – Banor i fshatit Kosterc: Fjala hyrëse. Kemi problem me bllokim të kanalizimit, është gjendja shumë e keqe. Gjithashtu, për rrugë tek varrezat e lagjes është e nevojshme shumë e kemi lëshu një parcelë të lagjes. Kur po ka të reshura po kemi telash me vërshime, po na mer uji, për shkak të disa gypave, urave.

Bekim Ademi – Banor i fshatit Runik: Fjala hyrëse. Kërkesa është për asfaltimin e rrugës që qon të varrezat e fshatit Runik. Kërkesa tjetër është për një mjek në ambulant dhe një autoambulant, sepse banorët po duhet me shku në Skenderaj ose Istog për shërbimet shëndetësore. Instalimi i ndriçimit, a është bërë pranimi teknik, sepse nuk po me duket në rregull, dritat nuk po bien në trotuar por më shumë në rrugë dhe në ara.

Nënkryetari i Komunës z. Fadil Nura: Vlerësoj se në kuadër të mundësive që i kemi pasur si Komunë, kemi realizuar projekte jo pak, përkundër vështirësive që i kemi pasur në implementimin e kontratës kolektive dhe bllokimeve të vazhdueshme që i kemi pasë, e kemi shembullin e subqendrës ku është bllokuar si projekt.

Të bllokimi i analizimit po kemi problem jo vetëm këtu por edhe në vende tjera. Kanalizimet duhet me u mirëmbajtur. Gjithçka po lidhet me problemet buxhetore që i kemi, kontratat kolektive i kanë marrë mjetet direkt nga projektet dhe kemi mbetur keq, sepse e ka prishë edhe shtruktura e planifikimit, sepse duhet ridestinim të mjeteve, duhet me i hëk dikun me i vendos dikun, me ndalë projekte krejt etj. Ne e kemi në procedurë të prokurimit kontraktimin e një kompanie që e mirëmbanë kanalizimin në territorin e Komunës tonë, në fshatra por edhe në qytet. Drejtorja e Shërbimeve Publike i ka pranuar këto kërkesa dhe i ka evidentuar se ku i kemi problemet në mënyrë që me iu jep zgjidhje.

Sa i përket rrugës, e di që është bërë zgjidhja e parcelës e keni lëshuar për rrugë në fshatin Kosterc. E kemi obligim dhe kemi me qu rrugën, me prioritet.

Sa i përket të vërshimit ne kemi tentuar me herët, mirëpo kemi probleme pronësore, jo vetëm atë por edhe në Kllodernicë. Prona private është e shenjtë dhe nuk e kemi të lejuar të ndërhyjmë vetëm përmes procedurave ligjore.

Të asfaltimi, të varrezat në Runik, kemi me bo gjithçka që me e kry. Drejtori e mer me prioritet dhe vitin e ardhshëm brenda mundësive me përfundu.

Për mjek, ne e kemi pasë premtimin me renovu ambulancën dhe e kemi kry. Për mjek kan qenë të pensionuar por në kontrata në vepër, u'a kam vazhdu deri sa i kemi rekrutu mjek të rinjë edhe pse me vërtetë nga auditori por skemi pasë zgjidhje tjetër ose me ua vazhdu, ose me mbetë ma

shërbime. Kurse tani kemi arritë me ba numrin e mjekëve të nevojshëm për QKMF, të njejtën kohë këto ditë ka me u përru një AMF e re të shkolla "Ahmet Delia" në lagjën tre dhe një mjek me e sjellë këtu që me qenë nonstop në ofrimin e shërbimeve.

Të ndriçimi, sa e pashë ish një ndriçim i mjaftueshëm, u doke trotuari, rruga, por ne jemi për ndonjë ankesë që mendoni që mundet me u bo ma mirë.

Aq sa pashë në Kosterc dhe në Runik prioritet i dhatë rrugës për tek varrezat edhe pse ka edhe degëzime të tjera.

Muhamet Dervishi – Banor i fshatit Kosterc: Fjala hyrëse. Me urgjencë e kemi kanalizimin ka dalë mbi ujë. Kompania që e ka ndërtu trotuarin i ka mbyllë disa procka dhe pastaj po bllokohet rrejdha e ujit. Era është e ran nga ujërat e zeza. Në jemi në një lagje 14 shtëpi rr. Elmi Dervishi 80m është e pashtuar me asfalt, ujë ska, mbeturina shumë, këto janë kërkesat.

Nënkryetari i Komunës z. Fadil Nura: Sipas mundësive do të bëhën të gjitha edhe ndriçimi edhe rrugët me rend, sipas mundësive buxhetore që i kemi si Komunë, do të përfundohen. Gjysmë milioni na i ka marrë kontrata kolektive dhe kemi mbetë në gjysëm për shkak të mjeteve, kur të hyjmë në Kosterc do të përfundohen të gjitha.

Daut Kajtazi – Banor i fshatit Terrnovë: Fjala hyrëse. Në broshurë po i shoh disa projekte. Të kanalizimi dhe ujësjellësi çka parashihet po i shoh disa renovim dhe rirregullim i tyre në disa fshatra.

Drejtori i Drejtorisë së Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Ambientit, z. Arbnor Çitaku: Fjala hyrëse. Për pjesën e Runikut, në kod të buxhetit për vitin e ardhshëm e kemi shti renovimin e një pjese të shkollës, sepse gjatë dimrit po hynë i ftohti dhe nxemja në shkollë, kaldaja nuk po funksionon si duhet, kanalizimi i shkollës nuk ka qenë i lidhur por tash është rregullu, në kod e kemi fut edhe sallën e sportit renovimin, ndërrimin e kulmit dhe pjesën e ndërrimit të terenit.

Projekti në total për tri vitet e ardhshme është 700 mijë euro duke e përfshijë edhe fushën e sportit në Runik.

Të pjesa e kanalizimit dhe ujësjellësit, në projekt është riparimi i sistemeve të ujësjellësit, në mënyrë që me pasë mundësi me i bo funksionale, kurse furnizimi me ujë bëhet nga Mitrovica. Rruga për të varrezat e fshatit Runik ka gjasa që të kryhet edhe këtë vit sepse nuk është shumë gjatë, ndërsa vitin e ardhshëm me u përfundu këto degëzimet sa kanë mbetë, rruga për të varrezat në Kosterc.

Të ndriçimi, është projekt në vazhdim, jo projekt i ri por në kuadër të subqendrës, ky model i dritave ka qenë edhe me herët ne e kemi vazhduar në atë model, atë projekt. Tani që i kemi bërë ne si intervenim i kemi ndryshuar kokat e dritave, sepse ato që kanë qenë më të dobëta, nga 100 volt në 200 volt, do e bëjmë edhe një intervenim të siguresat dhe përfundon si projekt.

Shaqir Dragaj – Banor i fshatit Leqinë: Fjala hyrëse. Çarkullimi i një video ditëve të fundit, a mundeni me ardhë dhe me shiku me ndonjë ekspert cili është kapaciteti i këtij burimi të ujit edhe e ja vlen me marrë këtë ujë dhe me shpërnda, me kyç me gyp të Syriganës?

Drejtori i Drejtorisë së Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Ambientit, z. Arbnor Çitaku: Unë kam biseduar me Lavdim Osmanaj, ekspert i ujërave, mirëpo duhet një organizim të studimit, të analizave të kapacitetit. Ka mbetë të na kthej një përgjigje për këtë çështje.

Bashkim Çitaku – Banor i fshatit Çitak: Fjala hyrëse: Kanalizimi të çitakt ka nevojë për intervenim.

Drejtori i Drejtorisë së Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Ambientit, z. Arbnor Çitaku: Ne kur e kemi filluar këtë mandat ka qenë kontrata për kanalizime që ka qenë në vazhdim dhe 70-80% e saj ka qenë e përfunduar. Jemi duke punuar në Runik dhe nëse mbeten mjete nga kontrata besoj që mundemi me përfunduar edhe atë pjesë, nëse jo për këtë vit atëherë për vitin tjetër do të kryhet.

Mergim Spahiu – Banor i fshatit Kostercë: Fjala hyrëse. Kërkesë për asfaltim të rrugës “Bajram Dervishi” është shumë e dëmtuar, sidomos kur bjen shi.

Nënkryetari i Komunës z. Fadil Nura: Siq e thash, pas përfundimit të degëzimeve në Kllodernicë, do të vazhdojmë në Kostercë dhe do të përfundohen në tërësi, gjithmonë sipas mundësive buxhetore.











A ka dikush tjetër? Po e mbylli këtë takim duke iu falënderuar për prezencën!

Procesmbajtëse:
Besjana Thaçi



Lista e pjesëmarrësve në dëgjimin e katërt buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2027 i mbajtur në Bashkësinë Lokale të Runikut

Data, vendi dhe ora: E premte, 21 Gusht 2026 – SHFMU “Shotë Galica”, Runik, 15:00

Nr	Emri dhe Mbiemri	Vendbanimi	Nr. telefonit	Nënshkrimi
1	Behar Spahija	Runike		
2	Altin Qorraj	Pemishtë		
3	Arsin Qorraj	Pemishtë		
4	Prosh Gjokaj	Lezhë		
5	Julian Huffer	Runik		
6	Laudim Derwishaj	Runik		
7	Artan Rama	Runik		
8	Cunë Kosterc	Kosterc		
9	Ferat Sëdini	Runik		
10	Agron Mehmetaj			
11	Sadat Hiscenaj			
12	Mergon Spahija	Runik		
13	Bobëri Miftari	Runik		
14	Mergim Spahija	Kosterc		
15	Astrit Spahija	Kosterc		
16	Bastri Spahija	Kosterc		
17	Petri Spahija	Kosterc		
18	Gëzim G. Joku			
19	Blashtim Gjokaj	Gjokaj		
20	Liridon	Hiscenaj		
21				
22				
23				

Lista e pjesëmarrësve në dëgjimin e katërt buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2027 i mbajtur në Bashkësinë Lokale të Runikut

Data, vendi dhe ora: E premte, 21 Gusht 2026 – SHFMU "Shotë Galica", Runik, 15:00

Nr	Emri dhe Mbiemri	Vendbanimi	Nr. telefonit	Nënshkrimi
1	Roshat Gifaku	Gifak	04470000	Devi
2	XHEVDËT LUMANI	RUNIK	04471270	
3	Petar SPAHII		04475000	
4	Migjen Spohija	Kostorë	04455000-843	Spohija
5	Daut Kajtazi	TERRNOVE	04470000	
6	Adrik Mucyri	Runik	04478100	Mucyri
7	Syle Dervishaj	LEÇINË		885
8	Agim Dervishaj	Runik	04479200	
9	Rahim Dervishaj	Runik	04463000	
10	KOSTRIM DRAGAJ	Runik	04444170	
11	Shagrir Dragaj	Leçinë	04424480	
12	Selver Spohija	Runik	04409780	
13	Michael Dervishaj	Kostorë	04434000	
14	Theriat Dervishaj	T. Kostorë		Shendy
15	TAHIR BAZRA	TERRNOVE	04440000	Bazra
16				
17				
18				
19				
20				
21				
22				
23				

Fotot e takimit të katërt publik buxhetor për buxhetin e vitit 2027, të mbajtur në Bashkësinë Lokale të Runikut

